

KONTRATE SHITJE KUOTASH

E lidhur sot me date 04/03/2024 ndermjet paleve te meposhtme:

SHITESI: **Znj. Ermira Mullaj**, atësia Edmond, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, në 04.05.1985, dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal. ID I55504007C, ortak i shoqërisë "E.N.D" Shpk.
Ketu e meposhte referuar si "Shitësi"

dhe

BLERESI: **Z. Dritan Leka**, atësia Bujar, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, në 27.06.1986, dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal. ID I60627019B,
Ketu e meposhte referuar si "Bleresi".

Palet kontraktuese pas nje bisedimi paraprak, vendosen perpilimin e kesaj kontrate me termat vijuese:

NENI 1 OBJEKTI

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e 1 kuote te shoqerise, qe perfaqeson 50% te kapitalit themeltar, te cilen Shitesi, Ermira Mullaj, e zoteron ne Shoqerine "E.N.D" shpk, me nr Nipti M41312015T, me objekt veprimtarie: Menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndertimin, dhenien me qira ose ne menaxhim, sikurse edhe shitjen e aktiviteteteve tregtare me shumice apo me pakice dhe te veprave dhe strukturave qe kane lidhje me keto aktivitete; ndertimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve per shitje te mallrave me shumice ose pakice, per llogari te vet apo te te treteve: blerjen, me per rifurnizimin, e mallrave ushqimore te pergjithshme, ne bashkepunim me shoqeri dhe entitete te tjera, si dhe import-eksportin e mallrave te ndryshme qe dote jene objekt i aktivitetit tregtar;hapjen dhe drejtimin e "Agjencive Doganore" ne te gjithe territorin e Shqiperise per kryerjen e cdo praktike doganore, pasi te jete pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme te leshuara nga organet kompetente; prodhimin, vete, ne forme te asociuar ose ne ortakeri me shoqata ose shoqeri te tjera, te produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen ne pikat e veta te shitjes ose te shoqerive ortake ose te kontrolluara prej saj si dhe/ose per eksportim;rritjen dhe shnderrimin e produkteve me origjine ushqimore, per qellime tregtimi brenda dhe jashte Shqiperise;dhenien me qira te pasurive te paluajtshme ne pergjithesi, blerjen; drejtimin, transformimin dhe shitjen e tokave bujqesore, sikurse dhe cdo veprim tjeter mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe studimin dhe ndertimin ose blerjen dhe shitjen e ndertesave qe kane lidhje me kete kategori;marrjen hua si dhe dhenien e dorezanive dhe garancive te tjera reale dhe personale, edhe ne favor te te treteve; drejtimin e veprimtarive tregtare me pakice ne bashkepunim edhe me shoqeri te tjera, me te cilat do te lidhe kontrata franchising dhe furnizimi. Prodhime brumi (furre buke). Shoqëria mund të kryej edhe cdo lloj

aktiviteti tjetër ndihmës dhe të nevojshëm që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk bie ndesh me ligjet shqiptare në fuqi, dhe adrese: Rruga Gjenerali Nikols, Pallati Shushica, Kati 0, Zk.8160, Tirane.

NENI 2 DEKLARIME DHE GARANCI

Shoqeria "E.N.D" shpk, është regjistruar si person juridik, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me datë 12/01/2024, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me nr Nipti M41312015T, Shiteshi është pronar i regjistruar i 100% të kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtave që burojnë prej saj.

Shiteshi, deklaron se në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate zoteron 100% të kuotave, dhe 50% të kuotave do të transferohet Blerësit, sipas kësaj kontrate dhe se ajo është e lirë nga çdo barër apo pretendim tjetër ligjor.

Blerësi, ka tagra të plota për të pranuar kuotën nga Shiteshi, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate nuk bie në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet dhe çdo dokument tjetër ligjor, subjekt i të cilave janë palet nëshkruese të kësaj kontrate.

Kjo Kontrate përben një detyrim ligjor të vlefshëm ndaj paleve, dhe është e detyrueshme për zbatim.

NENI 3 CMIMI I SHITJES

Shiteshi i shet Blerësit, 1 kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar në vlerë 50,000ALL, që zoteron në shoqërinë "E.N.D" shpk, kundrejt cmimit të shitjes së kuotës 50 000 (pesëdhjetë mijë leke);

NENI 4 TE DREJTAT DHE DETYRIMET

Shiteshi i shet Blerësit, 1 kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar që zoteron në shoqërinë "E.N.D" shpk.

Shiteshi mban përgjegjësi për titullaritetin e kuotës dhe që ajo të jetë e lirë nga çdo barër dhe pretendim tjetër ligjor.

Blerësi, blen 1 kuotë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar nga Shiteshi, duke pranuar në këtë mënyrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej tyre në gjendjen në të cilën ndodhet shoqëria, në datën në të cilën lidhet kjo kontratë shitje midis paleve.



Bleresi eshte i detyruar te paguaje cmimin e rene dakord ne kete kontrate, sipas modaliteteve te percaktuara.

NENI 5
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Në rast se ndërmjet palëve lindin mosmarrëveshje, ato do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre dhe në rast se nuk arrihet ky mirëkuptim, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Shkalles së Pare të Juridiksionit të Përgjithshëm të Tiranës.

NENI 6
TE TJERA

Pronesia mbi kuotën e shoqërisë, objekt i kësaj kontrate, kalon nga Shitesi tek Bleresi, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Kalimi i Pronesisë së Kuotës, në favor të Bleresit, do të regjistrohet në Qendren Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe Ligjin 9723/2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit".

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Ortaket e shoqërisë do të jenë Znj. Ermira Mullaj zotëuese e 50% të kapitalit dhe Z. Dritan Leka zotëues i 50% të kapitalit.

Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 3 kopje origjinale me vlerë të njëjtte provuese.

Palet e lexuan, rane dakord dhe e nënshkruan.

PALET

SHITESI
Ortaku i shoqërisë "E.N.D"

Ermira Mullaj



BLERESI

Dritan Leka